



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësi Org. Org. Jedinica Org Unit	01
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	05-682
Data: Datum:	31/01/2025
No. pages	-6-

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**

**Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health**  
**Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister**

**Nr. 05/01/2025**

**Datë: 31/01/2025**

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; duke marrë parasysh nenet 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7 / 01 Mars 2019), duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) Ligji nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe shtojcën 1 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1 të Rregullores nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, bazuar në Nenin 7, paragrafin 4 të Ligjit Nr. 08/1-220 Për çmimin e produkteve medicinale, nxjerrë këtë:

**V E N D I M**

1. Për përcaktimin e procedurës, formatit të aplikimit të deklaramit /ri deklaramit të çmimit dhe aplikimit për ndryshim të çmimit të produktit medicinal.
2. Shtojca 1 -Procedura, formati, aplikimi i deklaramit / ri deklaramit të çmimit dhe aplikimit për ndryshim të çmimit të produktit medicinal është pjesë e këtij vendimi.
3. Shtojca 2 - Formulari i deklaramit të çmimit të produktit medicinal është pjesë e këtij vendimi.
4. Obligohet Komisioni për përcaktimin e çmimeve të produkteve medicinale për zbatimin e këtij vendimi dhe të përcaktoj çmimin e produkteve medicinale në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.
- 5.Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Dr. Arbën Vitia

Ministër i Shëndetësisë



**Vendimi i dërgohet:**

- Kabinetit të Ministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit Ligjor;
- AKPPM;
- Divizionit të Farmacisë;
- Arkivit të MSH-së.

## **SHTOJCA I**

### **PROCEDURA, FORMATI, APLIKIMI I DEKLARIMIT / RI DEKLARIMIT TË ÇMIMIT DHE APLIKIMIT PËR NDRYSHIM TË ÇMIMIT TË PRODUKTIT**

#### **1.PROCEDURA E DEKLARIMIT**

1.1 Bartësi i autorizimit për marketing në Kosovë apo përfaqësuesi me autorizim të bartësit të autorizim marketingut (në tekstin e mëtejme aplikuesi) duhet të dorëzojë deklarimin e çmimit me shumicë për të gjitha produktet medicinale që janë të regjistruara sipas akteve ligjore përkatëse pranë AKPPM-së.

1.2 Deklarimi i çmimit të produkteve medicinale bëhet sipas formularit të bashkëngjitur në shtojcën II të këtij vendimi.

1.3 Së bashku me formularin për deklarim të çmimit, aplikuesi duhet të dorëzojë edhe dokumentacionin përcjellës si në vijim:

1.3.1 Letër përcjellëse nga BAM (Company Cover Letter);

1.3.2 Autorizimi për deklarimin e çmimit nga Bartësi i AM-së për aplikuesin (për përfaqësuesin);

1.3.3 Çertifikata e Autorizimit për Marketing;

1.3.4 Dëshmi mbi çmimin e importit;

1.3.5 Deklaratë nga Bartësi i Autorizimit për Marketing për produktet medicinale origjinator;

1.4 Aplikimi për deklarim të çmimit të produkteve medicinale bëhet në dhjetë ditëshin e parë të çdo muaji kalendarik (10 ditë pune).

#### **2.PROCEDURA E DEKLARIMIT TË ÇMIMIT TË PRODUKTEVE MEDICINALE PËR HERE TË PARË**

2.1 Bartësi i autorizimit për marketing në Kosovë apo përfaqësuesi me autorizim të bartësit të autorizim marketingut duhet të deklarojë çmimin e produkteve medicinale që janë pajisur me autorizim marketing për here të parë pranë AKPPM.

2.2 Deklarimi i çmimit të produkteve medicinale që janë regjistruar për here të parë pranë AKPPM bëhet në dhjetë ditëshin e parë të çdo muaji kalendarik (10 ditë pune).

2.3 Së bashku me formularin për deklaram të çmimit, aplikuesi duhet të dorëzojë edhe dokumentacionin përcjellës si në vijim:

2.3.1 Letër përcjellëse nga BAM (Company Cover Letter);

2.3.2 Autorizimi për deklaramin e çmimit nga Bartësi i AM-së për aplikuesin (për përfaqësuesin);

2.3.3 Çertifikata e Autorizimit për Marketing;

2.3.4 Dëshmi mbi çmimin e importit;

2.3.5 Deklaratë nga Bartësi i Autorizimit për Marketing për produktet medicinale origjinator;

### **3. PROCEDURA E RI-DEKLARIMIT**

3.1 Bartësi i autorizimit për marketing në Kosovë apo përfaqësuesi me autorizim të bartësit të autorizim marketingut duhet të bëjnë rideklaramin vjetor të çmimit të produkteve medicinale, të cilat e kanë të përcaktuar çmimin.

3.2. Aplikimi për deklaram të çmimit të produkteve medicinale bëhet në dhjetë ditëshin e parë të çdo muaji kalendarik (ditë pune).

3.3 Së bashku me formularin për ri deklaram të çmimit, aplikuesi duhet të dorëzojë edhe dokumentacionin përcjellës si në vijim:

3.3.1 Letër përcjellëse nga BAM (Company Cover Letter).

3.3.2 Autorizimi për deklaramin e çmimit nga Bartësi i AM-së për aplikuesin (për përfaqësuesin);

3.4.3 Çertifikata e Autorizimit për Marketing;

3.4.4 Dëshmi mbi çmimin e importit;

3.4.5 Deklaratë nga Bartësi i Autorizimit për Marketing për produktet medicinale origjinator;

### **4. PROCEDURA E APLIKIMIT PËR NDRYSHIM TË ÇMIMIT TË PRODUKTIT**

4.1. Ndryshimi i çmimit të produkteve medicinale bëhet nga bartësi i autorizimit për marketing në Kosovë apo përfaqësuesi me autorizim të bartësit të autorizim marketingut për shkak të rrethanave objektive të cilat ndikojnë në koston përfundimtare të produktit medicinal.

4.2 Aplikimi për ndryshim të çmimit të produkteve medicinale bëhet në dhjetë ditëshin e parë të çdo muaji kalendarik (10 ditë pune).

4.3 Së bashku me formularin për deklaram të çmimit, aplikuesi duhet të dorëzojë edhe dokumentacionin përcjellës si në vijim:

- 4.3.1 Letër përcjellëse nga BAM (Company Cover Letter).
- 4.3.2 Autorizimi për deklarimin e çmimit nga Bartësi i AM-së për aplikuesin (për përfaqësuesin);
- 4.3.3 Çertifikata e Autorizimit për Marketing;
- 4.3.4 Dëshmi mbi çmimin e importit;(CIP).
- 4.3.5 Deklaratë nga Bartësi i Autorizimit për Marketing për produktet medicinale origjinator;
- 4.3.6 Deklaratë autentike e detajuar nga Bartësi i Autorizimit për Marketing për arsyeshmërinë e ndryshimit të çmimit të produktit medicinal.

**SQARIM:**

Pavarësisht deklaramit të çmimit të importit nga Bartësit e Autorizim Marketingut apo përfaqësuesit e autorizuar (CIP) Komisioni verifikon çmimin e importit (CIP) nga institucionet përkatëse.

## SHTOJCA II

Formular i aplikimit për deklaram / rideklaram te çmimit /ndryshimin e çmimit

INFORMACION RRETH APLIKUESIT:	
Bartësi i Autorizimit për Marketing apo Përfaqësuesi me Autorizim të BAM	
Adresa e zyrës së regjistruar (qyteti, rruga, numri i shtëpisë, kodi postar):	
Vendi i selisë:	
Numri i telefonit/faksit:	
Personi kontaktues:	
E-mail adresa	

Deklarimi

Rideklarami

Ndryshimi

\* të pëzgjidhet lloji i deklaramit

TË DHËNAT PËR PRODUKTIN PËR TË CILIN DEKLAROHET ÇMIMI:	
Emri i barit	
Numri i Autorizim Marketingut(ku është e aplikueshme):	
Substanca aktive:	
ATC Kodi:	
Fortësia:	
Forma Farmaceutike:	
Madhësia e paketimit:	
Lloji i produktit (originator/gjenerik)	

Kursi i këmbimit të euros nga Banka Qendrore në datën e deklaramit

1 LEK =

EURO

1 MKD =

EURO

1 LEV =

EURO

\_\_\_\_\_

EURO

Çmimet aktuale për shitjet me shumicë për produktin e mësipërm në shtetet e referencës, të konvertuara në € aty ku është e përshtatshme

\*të plotësohen nga aplikuesi fushat e kaltra

Shtetet e referencës

Currency value

Shqipëri	LEK	0.0000	0.0000
Maqedoni	MKD	0.0000	0.0000
Mali i zi	EUR		0.0000
Kroaci	EUR		0.0000
Vendi i origjinës		0.0000	0.0000

Bullgari	LEV	0.0000	0.0000
Estoni	EUR		0.0000
Sloveni	EUR		0.0000
Tjetër (BE)	EUR		0.0000
Vendi i origjinës		0.0000	0.0000

Çmimi mesatar me shumicë	_____ €
--------------------------	---------

Çmimi i importit CIP	_____ €
----------------------	---------

<b>Dokumentacioni përcjellës që duhet bashkangjitur së bashku me formularin e deklarimit të çmimit:</b>	
<input type="checkbox"/>	Letër përcjellëse nga BAM (Company Cover Letter)
<input type="checkbox"/>	Autorizimi për deklarimin e çmimit nga Bartësi i AM-së për aplikuesin (për përfaqësuesin)
<input type="checkbox"/>	Certifikata e Autorizimit për Marketing (ku është e aplikueshme)
<input type="checkbox"/>	Dëshmi mbi çmimin e importit (CIP);
<input type="checkbox"/>	Deklaratë nga Bartësi i Autorizimit për Marketing për produktet medicinale origjinator
<input type="checkbox"/>	Deklaratë autentike e detajuar nga Bartësi i Autorizimit për Marketing për arsyeshmërinë e ndryshimit të çmimit të produktit medicinal.

<input type="checkbox"/> Deklaroj se informacionet e deklaruara në këtë kërkesë për përcaktimin e çmimit maksimal të lejuar me shumicë	
Personi i autorizuar i aplikantit:	
Nënshkrimi dhe vula:	
_____	
Prishtinë:	_____ , Datë _____